

BACHELOR

DEGA: GAZETARI

PROGRAMI I STUDIMEVE: BA

SILABUSET E LËNDËVE:

1. Titulli i lëndës: KOMUNIKIMI ORGANIZATIV

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë
Titulli i lëndës:	Komunikimi Organizativ
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i III-të , Semestri i V-të
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	6
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. ass. Gëzim Qerimi Ph.D
Të dhënat kontaktuese:	Email: gëzim.qerimi@uni-pr.edu Cel: +383(0)44- 344 388
Përshkrimi i lëndës:	Komunikimi organizativ trajton teoritë, strukturën, proceset dhe funksionet e komunikimit në një organizatë, të ndëridhura në mënyrë shkakësore me sjelljen e njerëzve, efektivitetin në punë dhe (pa) kënaqshmërinë me statusin profesional e shoqëror. Në fokus do të jenë shkathtësitë e komunikimit si një mjet për efektivitet dhe ndryshime në organizatë, me përqëndrim në natyrën e këtyre shkathtësive në nivel individual, grupor dhe organizativ. Problemet, çështjet dhe teknikat e komunikimit organizativ do të trajtohen dhe analizohen 2 përmes rasteve studimore, analizave, ushtrimeve e projekteve. Ekzaminimi i teorisë dhe shembujve do të ketë për qëllim që kandidatët të njihen me veçoritë dhe teknikat e komunikimit, i cili është efektiv për menaxhimin e organizatave. Ky modul ka disa objektiva: në radhë të parë, t’iu ofrojë kandidatëve njohuri më të thella mbi teorinë dhe kërkimet në fushën e komunikimit organizativ, për t’i kuptuar konceptet, modelet dhe teoritë në kërkimet e tyre duke zbatuar perspektiva të shumëllojshme me

	mundësi që të aftësohen të analizojnë kërkimet e bëra në mënyrë kritike.
Qëllimet e lëndës:	Aftësimi i studentëve që të njohin në mënyrë sa më të përthelluar e nuancuar formate komunikimit organizativ dhe efektte që kanë mbi funksionimin e mbarë organizatës e prej kendej edhe në shoqëri. Ejkspertiza e të aftësuarve në këtë sferë studimore, do të ndikonte në përmirësimin e komunikimit në organizata, kultivimin e kulturës së komunikimit dhe ngritje e vlerave në shoqëri, duke e rritur edhe mirëqenien e saj.

Rezultatet e pritshme të nxënies:	1. Vijuesi i këtij niveli të studimeve përvehtëson në mënyrë kritike teoritë kryesore, konceptet dhe terminologjinë me të cilën studiohet komunikimi organizativ dhe tërësia e efekteve dhe vlerave që prodhohen prej tij. 2. Vijuesi i këtij niveli të studimeve dhe këtij kursi krijon një pamje më të plotë dhe një botëkuptim shkencor mbi vlerat e komunikimit në organizata. 3. Vijuesi krijon edhe një fond njohurisht lidhur me organizatat që funksionojnë në vend dhe krahasueshmërinë e formave të komunikimit në to me format e komunikimit në kompani të ngjashme në vende demokratike që ëajnë trajtuar nga autorë të njohur, të përfshirë edhe në literaturën teorike. 4. Harton projekt studimor në këtë fushë dhe e realizon, nën mbikëqyrjen e mësimitdhënësit 5. Krijon gjykim kritik lidhur me teoritë ekzistuese të komunikimit organizativ dhe mundësitë e aplikimit të tyre në praktikë, po edhe të devijimit të tyre.
-----------------------------------	---

Metodat e mësimitdhënies:	Paraprakisht studentëve u jipet tema e caktuar dhe literatura adekuate ,që të përgatiten për diskutime e analiza. Inkurajohen diskutimet kritike ndaj literaturës 5 dhe ndaj prezenteve. Formulohen përfundime dhe rekomandime.	
Metodat e vlerësimit:	Është e rëndësishme që studentëve t'u jipen informata rreth mënyrës së vlerësimit, (në colloquium dhe provim final). Vlerësohet pjesëmarrja aktive në ligjërata e debate dhe vlerësimi final bëhet mbi hulumtimin me të cilin vijuesi ka qenë i ngarkuar. Vlerësimi kryesor konsiston në përcjelljen e punës hulumtuese të vijuesit, deri në arritjen e nivelit që të ketë vlerësimin pozitiv, që është dëshmi se vijuesi është aftësuar për të kryer hulumtim mirëfilli shkencor në këtë fushë studimore.	

	5% Prezantim 20% Testi i parë 20% Ushtrime 15% Seminari 40% Testi i dytë
Literatura primare:	Michael J. Papa, Tom D. Daniels, Barry K. Spiker, Kommunikimi Organizativ, UET Press, 2008 (shqip 209). Gëzim Qerimi, Komunikimi Organizativ, Rozafa, 2019, Prishtinë. Andri Koxhaj, Florian Tomini, Menaxhimi i komunikimit, albPAPER, Tiranë, 2011. Mary Ellen Guffey, Dana Loewy, Komunikimi në biznes, MEDIA print, 2017, Tiranë (shqip).
Literatura shtesë:	Keyton, J. (2005). Communication and organizational culture: A key to understanding work experiences. Thousand Oaks, CA: Sage. Clampitt, P.G. (2005). Communicating for managerial effectiveness (3rd ed.). Thousand Oaks, CA: Taylor, B.C. (2005). Postmodern theory. In S. May & D. K. Mumby (Eds.), Engaging organizational communication theory and research. Thousand Oaks, CA: Sage

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Komunikimi organizativ, filozofia dhe teoria e tij
Java 2:	Strukturat dhe funksionet e komunikimit organizativ
Java 3:	Komunikimi organizativ dhe kultura - diversiteti kulturor
Java 4:	Komunikimi organizativ dhe teknologjitë e informacionit
Java 5:	Hierarkia në organizatë dhe format e komunikimit
Java 6:	Pushteti në organizatë dhe përdorimi i komunikimit prej tij
Java 7:	Konfliktet në organizatë, të vështuara në dritën e informimit formal dhe joformal
Java 8:	Komunikimi strategjik: a ekziston
Java 9:	Ndërmarrjet publike joprofitabile dhe format e komunikimit organizativ: rasti i Kosovës

Java 10:	Rjetet sociale dhe komunikimi në organizatë
Java 11:	Komunikimi organizativ dhe integrimi i pakicave përmes barazisë së gjuhëve: rasti i Kosovës
Java 12:	Privatizimi i ndërmarrjeve publike dhe statusi i punëtorëve në aspektin e informimit: rasti i Kosovës
Java 13:	Roli i medieve publike e komerciale në përmirësimin e komunikimit në organizata
Java 14:	Përtej komunikimit organizativ: individi nën tryshninë e punëdhënësit dhe të manipulimit medial
Java 15:	-

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Politikat akademike janë standarde, në pajtim me Statutin e UPSë, Rregulloren e studimeve doktorale dheme etikën akademike e njerëzore.

